VENDIM
Nr. 67, datë 26.3.2018

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2018

Në mbështetje të neneve 16 dhe 84, pikës 4, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2018,"

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 3818 prot., datë 1.3.2018 (protokolluar në ERE me nr. 171/4 prot., datë 5.3.2018), ka përcjellë në ERE aplikimin për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin mars 2018.

- Nga analiza që iu bë aplikimit të OSHEE sh.a. mbi përcaktimin e përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, rezulton se sipas llogaritjeve të OSHEE sh.a., çmimi për muajin mars 2018 është 7.74 lekë/kWh.

- OSHEE, me gjithë komunikimet e vazhdueshme të zhvilluara në kuadër të procesit të nisur mbi miratimin e çmimit të shitjes për klientët e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për periudhën janar dhe shkurt 2018, nuk ka mundur të paraqesë informacion mbi koston e disbalancave për njësi të energjisë së furnizuar në rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit edhe për muajin mars 2018.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 9.5 lekë/kWh për muajin mars 2018.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalenda-rike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti